



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

**Data : 25.01.2019**

**Drejtuar: Operatori ekonomik “Albtelecom” sh.a**

**Adresa:** Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane - Durres, km.7

**Procedura e prokurimit:** e zgjedhur në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Neni 35/1 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu IV, Neni 33; si dhe Kreut V, Neni 45, pika 1, udhëzimit Nr 10 dt. 01.11.2017 për “Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr 6 dt. 27.01.2015” për përdorimin e marrëveshjes kuadër” (i ndryshuar), si edhe rekomandimit Nr. 13566 Prot dt 06.11.2017 nga Agjensia e Prokurimit Publik është “**Procedurë e Hapur/marrëveshje kuader**”.

**Numri i referencës së procedurës/lotit REF-97462-12-07-2018**

Loti II: REF-97466-12-07-2018

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** *“Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike dhe shërbime data, si dhe ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban”, i ndarë sipas loteve:*

**Loti II:** *“Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban”, per ofrimin e shërbimit të internetit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.*

Afati kohor për kryerjen e Loti II: “Ofrimi i shërbimit online për monitorimin e trafikut urban”, **do të jetë për një periudhë kohore 3 (tre) vjecare, duke filluar nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër (sipas detajimit në shtojcën 11) .**

**Fondi limit: 112,497,421 (njëqind e dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e njëzetë e një) lekë pa tvsh. Loti II:** “ fond limit 62,497,774 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa T.V.SH.

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2018”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **03/01/2019, Ora: 11:00**

*Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 50 datë 17.12.2018.***

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Albtelecom” sh.a

**J61824053N**

**Vlera e Ofertës pa tvsh = 60,696,480 (gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë).**

2. “Abcom”

**K11308001B**

**Vlera e Ofertës pa tvsh = 61,880,000 (gjashtëdhjetë e një milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë).**

Është skualifikuar operatori ekonomik i mëposhëm:

1. “Abcom”

**K11308001B**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 9.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

a. Operatori ekonomik “ABCOM” sh.p.k sh.p.k, nuk ka paraqitur formularin e ofertës sipas formatit të preventivit të publikuar bashkëlidhur dokumentave të kësaj procedure prokurimi.

Për sa më sipër Operatori ekonomik “ABCOM” sh.p.k nuk plotëson një nga kërkesat bazë të një procedure prokurimi sikurse është ai i formularit të ofertës, pra “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ pika 1/c”.

b. Operatori ekonomik “ABCOM” sh.p.k sh.p.k, nuk ka paraqitur licencat përkatëse të lëshuara nga AKEP mbi teknologjinë 3G/ 4G/ LTE, sipas kërkesave të pikës 3, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik të dokumentave standarte të tenderit.

Për operatorin ekonomik “ABCOM” sh.p.k nuk plotëson “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti

teknik/ pika 3”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. “Albtelecom” sh.a

J61824053N

***Vlera e Ofertës pa tvsh = 60,696,480 (gjashtëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë).***

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.01.2019

**Ankesa:** Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

